

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	00 Nr.42/2022	Data: 31.03.2022	

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe neni 40 paragrafi 40.2 pika e) të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008), duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASH) Nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedura e zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimtar të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, dhe në pajtim me nenin 33. Paragrafi 33.1. pika 5) të Statutit të Komunës 01 Numër 62/10. Me kërkesën nga Drejtoria e Arsimit në komunën e Istogut me 05 Nr. 22/21, në mbledhjen e mbajtur më: 31.03.2022 mori këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E DREJTORËVE DHE ZËVENDËS DREJTORËVE NË SHKOLLAT E KOMUNËS SË ISTOGUT

1. Formohet Komisioni për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zv. drejtorëve në shkollat e komunës së Istogut.
2. Në komision caktohen:
 1. Naim Sadriu, Zyrtar nga Drejtoria e Arsimit në Komunën e Istogut, Kryesues i Komisionit;
 2. Mimoza Kabashi, Drejtoreshë në Shkollën fillore "Martin Camaj" në Gurrakoc, anëtare.
 3. Një anëtar nga Ministra e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, (MASHTI).
3. Komisioni i cekur më lartë, në pajtim me Udhëzimin Administrativ (MASH) Nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësuese Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedura e zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimtar të kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm.
4. Komisioni vlerësues do të kryej të gjitha punët e caktuara me Legjislacionin në fuqi, dhe do të ketë mandatin një vjeçar.
5. Obligohet Drejtoria për Arsim që t'i kryej të gjitha punët administrativo - teknike të domosdoshme për komision.
6. Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës.
7. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtorati i Arsimit, Ministra e Administratës së Pushtetit Lokal, anëtarët e komisionit dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.